



Raporti i Punës për vitin 2023

Inspektorati Qendror i Punës



INSPEKTORATI
QENDROR I PUNËS



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2023

Prishtinë, 2024

Raporti i hartuar është bazuar në raportet e hartuara nga Departamenti për Çështje Ligjore dhe Planifikim Strategjik në Inspektoratin Qendror të Punës.

Përmbajtja

Tabela e figurave	5
Fjalë e Kryeinspektorit z. Hekuran Nikçi	6
Inspektorati Qendror i Punës	7
Pjesa ekzekutive	7
Ligjet dhe aktet nënligjore zbatimin e të cilave e mbikëqyr Inspektorati Qendrori Punës.....	7
Realizimi i detyrave të punës nga Inspektorati Qendror i Punës në vitin 2023.....	9
Zyra e Kryeinspektorit.....	9
Strategjia zhvillimore 2023-2027	9
Sistemi informativ dhe inspektimet elektronike	9
Veprimtaria e organit të shkallës së dytë	9
Komisioni i organit të shkallës së dytë.....	9
Divizioni i Prokurimit.....	10
Procedurat e planifikuara dhe të realizuara	10
Procedurat të cilat nuk janë realizuar	10
Kontrata jashtë Planit të Prokurimit 2023.....	10
Kategorizimi dhe numri i kontratave sipas vlerës.....	11
Lloji i kontratave dhe realizimi i tyre.....	11
Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme;.....	11
Të hyrat totale për vitin 2023	12
Divizioni i Burimeve Njerëzore	12
Rritja e numrit të punonjësve.....	12
Struktura e inspektorëve të punës	13

Struktura profesionale e inspektorëve të punës.....	13
Rekrutimi i inspektorëve të rinj.....	13
Grafika për inspektorët e rekrutuar në vitin 2023.....	13
Departamenti për Çështje Ligjore dhe Planifikim Strategjik.....	15
Përfundime dhe rekomandimet	16
Grafikonet.....	18
Raporti zyrtar	18
Marrëdhënia e punës.....	22
Siguria dhe shëndeti në punë	24

Tabela e figurave

Grafiku 1. Inspektorët e rekrutuar në 2023 sipas rajonit dhe gjinisë	11
Grafiku 2. Inspektorët e rekrutuar në 2023 sipas profesionit	12
Grafiku 3. Numri i inspektimeve ndër muaj	16
Grafiku 4. Inspektimet sipas sektorit	16
Grafiku 5. Inspektimet sipas ankesës ndër muaj	17
Grafiku 6. Inspektimet sipas veprimtarisë	17
Grafiku 7. Inspektimet sipas llojit	18
Grafiku 8. Masat administrative	18
Grafiku 9. Punëtorët/et e inspektuar ndër muaj	19
Grafiku 10. Punëtorët/et me kontrata të punës ndër muaj sipas gjinisë	20
Grafiku 11. Punëtorët/et pa kontrata të punës ndër muaj sipas gjinisë	20
Grafiku 12. Shkeljet e evidentuara në orar të punës	21
Grafiku 13. Shkeljet e evidentuara në pushime	21
Grafiku 14. Trajnimi i punëtorëve ndër muaj	22
Grafiku 15. Vlerësimi i riskut në vend të punës	22
Grafiku 16. Obligimet e punëdhënësit	23
Grafiku 17. Të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve/eve	23
Grafiku 18. Kushtet teknike	24
Grafiku 19. Kontrollat mjekësore	24
Grafiku 20. Aksidentet	25
Grafiku 21. Aksidentet e lehta sipas veprimtarisë	25
Grafiku 22. Aksidentet e rënda sipas veprimtarisë	26
Grafiku 23. Aksidentet me fatalitet sipas veprimtarisë	26

Fjalë e Kryeinspektorit z. Hekuran Nikçi

Në emrin tim personal dhe në cilësinë e kryeinspektorit në Inspektoratin Qendror të Punës, dëshiroj të ndaj disa nga sukseset që kemi arritur gjatë vitit 2023. Në thelb të misionit tonë është mbrojtja e të drejtave të punës, sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës. Kemi punuar me përkushtim për të garantuar këto të drejta dhe për të siguruar një ambient të punës të sigurt dhe të drejtë për të gjithë.

Përmirësimi i transparencës dhe bashkëpunimit ka qenë pjesë thelbësore e përpjekjeve tona, drejt një bashkëpunimit të hapur me akterë të ndryshëm, duke përfshirë mediat, sindikatat, dhe institucionet tjera.

Për inspektorët tanë, kujdesi i vazhdueshëm për t'i mbajtur ata të përditësuar dhe për t'u siguruar qasje dhe mbështetje të nevojshme është thelbësor për përsosmërinë e punës së tyre. Ndërkaq, përkushtimi im ndaj kultivimit të një kulture të integritetit ka vazhduar me synim promovimin e sjelljes etike dhe tolerancës zero ndaj shkeljeve të legjislacionit.

Bashkëpunimi dhe iniciativat e ndërmarra me institucione qeveritare, organizata ndërkombëtare dhe joqeveritare, si dhe partneritetet me organizatat e punëdhënësve dhe punëtorëve, kanë kontribuar në adresimin e sfidave të punëtorëve në Kosovë dhe në gjetjen e zgjidhjeve efektive për mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Si përfundim, me hartimin dhe miratimin e Strategjisë Zhvillimore të Inspektoratit Qendror të Punës për periudhën 2023-2027, jemi të vendosur të vazhdojmë përpjekjet tona për të përmirësuar dhe thelluar mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së ligjeve që monitorojmë, me synimin që të gjithë punëtorët të gëzojnë kushte të mira të punës në Republikën e Kosovës.

Faleminderit për besimin dhe përkrahjen tuaj në këtë rrugë të rëndësishme drejt një ambienti të punës më të sigurt dhe të drejtë për të gjithë.

Inspektorati Qendror i Punës

Inspektorati Qendror i Punës është organ i pavarur ekzekutiv i mandatuar me legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave ligjore pozitive të cilat rregullojnë marrëdhëniet juridike kontraktuale, të drejtat dhe detyrimet e palëve në raportet e krijuara juridike në procesin e punës.

Inspektorati Qendror i Punës udhëhiqet nga Kryeinspektori, mbështetur nga dy zëvendësit e tij me përgjegjësi (për marrëdhënien e punës, sigurinë në punë). Kryeinspektori për punën e tij dhe të institucionit që ai udhëheq i raporton drejtpërdrejt ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Struktura e Inspektoratit Qendror të Punës përbëhet nga pjesa ekzekutive dhe pjesa administrative.

Pjesa ekzekutive

- Kryeinspektori;
- Dy (2) zëvendësit e Kryeinspektorit (zëvendësi për marrëdhënie pune, zëvendësi për siguri në punë) dhe inspektorët e punës.

Pjesa administrative

- Departamenti për Çështje Ligjore dhe Planifikim Strategjik;
- Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;
- Divizionet Rajonale për Koordinim (7 rajone);
- Divizioni i Prokurimit;
- Divizioni i Burimeve Njerëzore.

Ligjet dhe aktet nënligjore zbatimin e të cilave e mbikëqyr Inspektorati Qendror i Punës

Inspektorati Qendror i Punës, si institucion i vetëm shtetëror për mbikëqyrjen e legjislacionit të punës, ka përgjegjësi të kujdeset për zbatimin dhe respektimin e ligjeve dhe akteve nënligjore të cilat rregullojnë sferën e punës. Kjo përfshin një

gamë të gjerë të ligjeve dhe ndryshimeve nënligjore që ndikojnë në marrëdhëniet e punës, sigurinë dhe shëndetin në procesin e punës. Rrjedhimisht, IQP kujdeset për zbatimin e ligjeve në vijim:

- **Ligjit Nr.03/L-212 të Punës,**
- **Ligjit Nr.04/L-161 për Siguri dhe Shëndet në Punë**
- **Ligji 08/L-067 për Inspektimet**

Përveç ligjeve kryesore IQP-ja mbikëqyr edhe zbatimin e disa dispozitave të veçanta të disa ligjeve tjera si në vijim:

- **Ligji nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit;**
- **Ligji nr. 03/L-200 për Grevat;**
- **Ligji nr.03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara;**
- **Ligji Nr.04/L-219 Për të Huajt;**
- **Ligji Nr.04/L-011 për Organizimin Sindikal në Kosovë;**
- **Ligji Nr.02/L-81për Nxitjen dhe Mbrojtjen e të Ushqyerit me Qumësht Gjiri.**
- **Ligji Nr.06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve**

IQP-ja mbikëqyr edhe zbatueshmërinë e akteve nënligjore që burojnë nga këto ligje e që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës, sigurinë dhe shëndetin në punë.

Fushat e zbatimit të këtyre ligjeve përfshijnë çështje që lidhen me sektorin publik dhe privat, duke mbuluar marrëdhënien e punës, sigurinë dhe shëndetin në punë.

Realizimi i detyrave të punës nga Inspektorati Qendror i Punës në vitin 2023

Zyra e Kryeinspektorit

Në vitin 2023, Inspektorati Qendror i Punës ka kaluar një periudhë vendimtare, duke shënuar progres drejt efikasitetit të tij. Në këtë kontekst, Zyra e Kryeinspektorit ka udhëhequr një rrugëtim sfidues drejt përmirësimit të strukturës, teknologjisë dhe efikasitetit të përgjithshëm të institucionit. Në vijim, janë disa nga sukseset kyçe të shënuara nga Zyra e Kryeinspektorit në Inspektoratin Qendror të Punës:

Strategjia zhvillimore 2023-2027

Në vitin 2023, Zyra e Kryeinspektorit ka shënuar një hap të rëndësishëm me hartimin dhe aprovimin e Strategjisë Zhvillimore të Inspektoratit Qendror të Punës për periudhën 2023-2027. Ky dokument përcakton vizionin dhe objektivat afatgjata të institucionit, duke krijuar një bazë strategjike për rritjen dhe avancimin e performancës së Inspektoratit në të ardhmen.

Sistemi informativ dhe inspektimet elektronike

Në këtë vit, është filluar puna për implementimin e Sistemit informativ të Inspektoratit Qendror të Punës, i cili përfshin inspektime elektronike dhe siguron statistika në kohë reale. Ky ndryshim teknologjik do të lejojë përmirësim të procesit të inspektimit, duke lejuar mbledhjen dhe analizën e të dhënave në mënyrë më efikase dhe transparente.

Veprimtaria e organit të shkallës së dytë

Nga muaji dhjetor 2023, me Vendimin Nr. 66 datë 18.12.2023, organi i shkallës së dytë ka filluar veprimtarinë e tij brenda kuadrit të Ministrisë së Financave dhe Punës dhe Transfereve (MFPT).

Komisioni i organit të shkallës së dytë

Gjatë vitit 2023, komisioni i organit të shkallës së dytë ka shqyrtuar 600 ankesa të paraqitura ndaj vendimeve të inspektorëve të punës. Ky proces reflekton një

përkushtim të vazhdueshëm për transparencë dhe mbrojtje të të drejtave të punonjësve, duke rritur efikasitetin dhe integritetin e procesit të inspektimit.

Gjithashtu, komisioni i organit të shkallës së dytë gjatë vitit 2023 ka arritur t'i trajtoj ankesat e palëve brenda afatit ligjor, të cilat paraprakisht trajtoheshin jashtë afatit ligjor.

Konsiderojmë se këto zhvillime strategjike ndihmojnë në forcimin e rolit të institucionit dhe sigurojnë një shërbim më të mirë dhe të përshtatshëm për punëtorët dhe punëdhënësit në ambientet e punës.

Divizioni i Prokurimit

Divizioni i Prokurimit në Inspektoratin Qendror të Punës ka zhvilluar një vit të suksesshëm në implementimin e Planit të Prokurimit për vitin 2023. Tutje, paraqitet një vlerësim i detajuar për të arriturat e këtij divizioni gjatë vitit 2023, duke përfshirë planifikimin e procedurave, realizimin e tyre, dhe çështjet e paplanifikuara të trajtuara nga Agjensioni Qendror i Prokurimit.

Procedurat e planifikuara dhe të realizuara

Planifikimi ka paraparë 15 procedura të prokurimit.

- Dymbëdhjetë (12) procedura janë realizuar, duke theksuar përkushtimin ndaj planifikimit të mirë të burimeve dhe koordinimit efektiv.

Procedurat të cilat nuk janë realizuar

Tri (3) procedura nuk janë realizuar, përfshirë:

- Furnizim me gardërobë zyrtare për IP;
- Blerja e veturave zyrtare;
- Servisimi i klimave.

Kontrata jashtë Planit të Prokurimit 2023

Disa kontrata janë realizuar jashtë planit, si procedura janë kërkuar nga Agjensioni Qendror i Prokurimit (AQP), duke përfshirë:

- Shtrirjen e rrjetit të internetit në zyrat e IQP në Gjilan;
- Asgjësimin e materialeve të pa përdorshme nga letra dhe druri;

- Sigurimin TPL, TPL+, dhe sigurimin Kasko të automjetit të IQP-së, Ford.

Kategorizimi dhe numri i kontratave sipas vlerës

- Tri (3) kontrata me vlerë të mesme;
- Pesë (5) kontrata me vlerë të vogël nga procedurat e kuotimit;
- Shtatë (7) kontrata me vlerë minimale.

Lloji i kontratave dhe realizimi i tyre

- Dhjetë (10) procedura të kontratave për furnizim janë realizuar në përputhje me planin e prokurimit;
- Katër (4) procedura të kontratave për shërbim janë realizuar në përputhje me planin e prokurimit;
- Një (1) procedurë e kontratës për punë është realizuar në përputhje me planin e prokurimit;
- Një (1) procedurë për blerjen e një (1) veture, është realizuar me procedurat e përgatitura nga Agjensioni Qendror i Prokurimit (AQP).

Rrjedhimisht, Divizioni i Prokurimit ka shfaqur përkushtim dhe efikasitet në implementimin e Planit të Prokurimit për vitin 2023. Edhe pse ka pasur disa procedura të paplanifikuara, reagimi i shpejtë dhe bashkëpunimi me Agjencionin Qendror të Prokurimit (AQP) ka lejuar menaxhimin e tyre me sukses. Në përgjithësi, divizioni ka kontribuar në sigurimin e nevojave të Inspektoratit Qendror të Punës dhe ka ruajtur standarde të larta të kualitetit në prokurimin e produkteve dhe shërbimeve.

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme ka shënuar një vit të shquar me arritje të jashtëzakonshme gjatë vitit 2023. Buxheti fillestar i aprovuar i Inspektoratit Qendror të Punës për vitin 2023 ka qenë 1,575,632.00 Euro. Nën udhëheqjen e këtij departamenti, disa nga pikat kyçe që vlen të theksohen janë:

Të hyrat totale për vitin 2023

Të hyrat totale për vitin 2023 në Inspektoratin Qendror të Punës janë 1,072,150.62 Euro, duke shënuar një rritje të konsiderueshme nga vitin 2022, kur ato ishin 581,367.85 Euro dhe viti 2021 ku ishin 412,132.00 të hyra totale.

Përmirësimi i mjedisit të punës dhe efikasiteti

Gjatë vitit 2023, janë zhvilluar veprime për përmirësimin e mjedisit të punës brenda IQP-së. Në veçanti, zyrat e Inspektoratit Qendror të Punës në rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt janë renovuar, duke përmirësuar kushtet dhe efikasitetin e punës në këto rajone. Po ashtu, janë kryer ndryshime dhe përmirësime në zyrat qendrore të IQP-ës.

Këto të arritura shënojnë një angazhim të vazhdueshëm ndaj përmirësimit të cilësisë së shërbimeve dhe efikasitetit të punës në kuadër të Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme në Inspektoratin Qendror të Punës.

Divizioni i Burimeve Njerëzore

Gjatë vitit 2023, Divizioni i Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Qendror të Punës ka shënuar përmirësim të rëndësishëm, sidomos në aspektin e rekrutimit të stafit të ri.

Rritja e numrit të punonjësve

Në fund të vitit 2023, numri i të punësuarve në Inspektoratin Qendror të Punës ka shkuar në 83 punëtorë, një rritje e konsiderueshme krahasuar me vitin 2022, kur kanë qenë vetëm 64 të punësuar në IQP. Kjo rritje shënon një angazhim të madh për zgjerimin dhe forcimin e kapaciteteve njerëzore të institucionit.

Struktura e inspektorëve të punës

Numri i përgjithshëm i inspektorëve të punës që ushtrojnë funksionin e tyre në tërë territorin e Republikës së Kosovës është 62. Ndër ta, 44 janë burra dhe 18 janë gra.

Struktura profesionale e inspektorëve të punës

Sipas strukturës profesionale: 38 nga drejtimi juridik, 4 nga teknologjia ushqimore dhe bioteknologjia, 4 nga inxhinieria e mekanikës, 4 nga kimia, 3 nga drejtimi ekonomik, 2 nga drejtimi i ndërtimtarisë/arkitekturës, 2 nga biologjia dhe 5 inspektorë të tjerë i takojnë drejtimeve si hidroteknika, menaxhment - informatikë, shkenca politike, xehtari dhe metalurgji, si dhe agroekonomi.


Rekrutimi i inspektorëve të rinj

Gjatë vitit 2023, është shënuar një hap i rëndësishëm me rekrutimin e 30 inspektorëve të rinj. Ky përmirësim është konsideruar si një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të kapaciteteve dhe efikasitetit të Inspektoratit Qendror të Punës.

Grafika për inspektorët e rekrutuar në vitin 2023


Për të pasqyruar këtë zhvillim, janë përgatitur grafika të cilat theksojnë rritjen e numrit të inspektorëve të rinj dhe ndarjen e tyre sipas gjinisë dhe profesioneve. Këto grafika paraqesin një vështrim të qartë mbi diversitetin dhe forcimin e ekipit të Inspektoratit Qendror të Punës.

Inspektorët e rekrutuar në 2023 sipas rajonit dhe gjinisë



Grafiku 1. Inspektorët e rekrutuar në 2023 sipas rajonit dhe gjinisë

Inspektorët e rekrutuar në 2023 sipas profesionit



Grafiku 2. Inspektorët e rekrutuar në 2023 sipas profesionit

Departamenti për Çështje Ligjore dhe Planifikim Strategjik

Gjatë vitit 2023 Inspektorati Qendror i Punës ka kryer **8,114** inspektime në total: të planifikuara **3,874**; të përsëritura **2770**; të jashtëzakonshme (rastësore) **44**; Inspektime për shkak të aksidenteve në punë **330**; Inspektime në bashkëpunim me institucionet tjera të mbikëqyrjes **280** dhe inspektime sipas ankesës së palëve **1,348**. Në inspektimet e kryera janë trajtuar gjithsej **53,887** punëtorë. Nga numri i përgjithshëm i punëtorëve (**31964** burra, dhe **21,923** gra). Gjatë vitit 2023 me prioritet janë trajtuar rastet e aksidenteve në vend të punës në të cilat kanë pësuar lëndime punëtorët që kryenin punë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Gjithsej kanë ndodhur **330 aksidente**, ku me fatalitet ose vdekje në punë kanë përfunduar **11** nga ato.

Shkeljet më të shpeshta të dispozitave ligjore të cilat i kanë bërë punëdhënësit ndaj punëtorëve në lëmin e marrëdhënies së punës janë: moskompensimi për punën gjatë festave zyrtare, pushimit vjetor, punën gjatë fundjavës, punën në ndërrim të natës, kompensimet, dhe largimin nga puna.

Nga siguria dhe shëndeti në punë parregullsitë më të shpeshta të evidentuara kanë qenë: mungesa e trajnimit të punëtorëve, mungesa e vlerësimit të riskut në vendin e punës, (mos) përdorimi i pajisjeve personale mbrojtëse, dhe numri i ulët i kontrolleve mjekësore.

Për parregullsitë e gjetura në mos respektimin e dispozitave ligjore janë ndërmarrë masat administrative si në vijim: **3,190** vërejtje, **1,067** masa ndëshkuese-gjoka, dhe **98** pezullime punimesh.

Përfundime dhe rekomandimet

Gjatë vitit 2023 Inspektorati Qendror i Punës në Kosovë ka shënuar përparim në zbatimin e Ligjit të Punës dhe Ligjit për Siguri dhe Shëndetit në Punë. Megjithatë, mbetet ende një sfidë e madhe për të garantuar se të gjithë punëtorët gëzojnë kushte të punës të sigurta dhe të mira. Për të përmirësuar më tej performancën e Inspektoratit Qendror të Punës, ka nevojë për veprime të tjera të vendosura dhe të koordinuara.

Rritja e transparencës dhe llogaridhënies në këtë institucion ka qenë një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të funksionimit të tij. Rritja e numrit të inspektorëve, zhvillimi i kapaciteteve teknike brenda IQP-së dhe sigurimi i trajnimeve kanë ndikim të dukshëm në aftësitë e tyre për të kryer detyrat me efikasitet. Në të njëjtën kohë, thellimi i kulturës së integritetit brenda institucionit do të kontribuojë në ndërtimin dhe ruajtjen e besimit në veprimtarinë e Inspektoratit.

Në përpjekje për të përmirësuar bashkëpunimin dhe marrëdhëniet me palët e interesit jashtë institucionit, përfshirë mediat, sindikatat dhe institucionet tjera, transparenca duhet të mbetet një prioritet në punën e Inspektoratit Qendror të Punës edhe gjatë vitit 2024. Kjo mund të arrihet përmes ndarjes së informacionit dhe përfshirjes së tyre në proceset konsultative.

Për të vazhduar përparimin në zbatimin e ligjeve që janë në kompetencë të Inspektoratit Qendror të Punës, propozojmë disa rekomandime:

- Përmirësimi i koordinimit mes Inspektoratit Qendror të Punës dhe organeve të tjera relevante për të adresuar çështje komplekse, duke krijuar një bashkëpunim të ngushtë dhe koordinim të veprimtarive për zbatimin e standardeve të punës dhe sigurisë në ambientin e punës.
- Rritja e numrit të inspektorëve, profilizimi i tyre në fusha të ndara dhe avancimi i kushteve teknike brenda IQP-së. Kjo nxitje synon të sigurojë një mbulim më të gjerë dhe më të përshtatshëm të fushave inspektuese.


Investimi në avancimin e kushteve teknike do t'i mundësojë inspektorëve të realizojnë detyrat e tyre me një kujdes më të madh dhe të zbatojnë mbikëqyrjen në mënyrë më të përshtatshme sipas specifikave të çdo sektori. Në këtë drejtim, ndarja e inspektorëve në dy grupe, inspektorë të punës dhe inspektorë të sigurisë dhe shëndetit në punë, do të mundësojë specializimin e tyre në fusha të caktuara. Ky organizim do të sjellë njohuri të specializuara, duke përmirësuar aftësitë e tyre për të identifikuar dhe adresuar sfidat specifike që lidhen me ligjet e punës dhe sigurinë, shëndetin në punë.

- Përmirësimi i komunikimit me publikun dhe informimi i rregullt i punëtorëve rreth të drejtave dhe detyrimeve të tyre në vendin e punës është një qëllim kyç për të ndërtuar një marrëdhënie të fortë dhe transparente mes Inspektoratit Qendror të Punës dhe komunitetit punëtor. Duke krijuar një strategji efektive të komunikimit, Inspektorati do të sigurojë që informacioni relevant të arrihet në mënyrë të qartë dhe në kohë tek punëtorët.
- Krijimi i Sistemi informativ dhe inspektimeve elektronike në Inspektoratin Qendror të Punës synon të bëjë punën e inspektorëve të punës më të lehtë dhe efikase. Ky transformim do të lehtësojë detyrat e tyre, duke mundësuar operim më të saktë, më të shpejtë dhe të lehtë. Përdorimi i teknologjive digjitale për regjistrim, dokumentim dhe raportim të inspektimit do të përmirësoj procesin duke e bërë atë më efikas dhe transparent. Kjo do të ndihmoj në koordinimin e mëtejshëm dhe përgjigjen më të shpejtë ndaj sfidave gjatë inspektimeve. Investimi në sistemin informativ dhe inspektimeve elektronike do të sjell një lehtësim të theksuar në punën e Inspektoratit Qendror të Punës dhe do të ndikoj në përmirësimin e përgjithshëm të tij.


Këto rekomandime synojnë të kontribuojnë në ndërtimin e një sistemi më efektiv dhe transparent të mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit të punës në Kosovë.

Grafikonet

Raporti zyrtar



Grafiku 3. Numri i inspektimeve ndër muaj




Grafiku 4. Inspektimet sipas sektorit

Inspektimet sipas ankesës ndër muaj




Grafiku 5. Inspektimet sipas ankesës ndër muaj

Inspektimet sipas veprimtarisë




Grafiku 6. Inspektimet sipas veprimtarisë

Inspektimet sipas llojit




Grafiku 7. Inspektimet sipas llojit

Masat administrative




Grafiku 8. Masat administrative

Punëtorë/e të inspektuar/a ndër muaj




Grafiku 9. Punëtorët/et e inspektuar ndër muaj

Marrëdhënia e punës




Grafiku 10. Punëtorët/et me kontrata të punës ndër muaj sipas gjinisë




Grafiku 11. Punëtorët/et pa kontrata të punës ndër muaj sipas gjinisë

Shkeljet e evidentuara në orar të punës



Grafiku 12. Shkeljet e evidentuara në orar të punës


Shkeljet e evidentuara në pushime



Grafiku 13. Shkeljet e evidentuara në pushime

Siguria dhe shëndeti në punë

Trajnimi i punëtorëve ndër muaj




Grafiku 14. Trajnimi i punëtorëve ndër muaj

Vlerësimi i riskut në vend të punës




Grafiku 15. Vlerësimi i riskut në vend të punës

Obligimet e punëdhënësit




Grafiku 16. Obligimet e punëdhënësit

Të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve/eve



Grafiku 17. Të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve/eve

Kushtet teknike




Grafiku 18. Kushtet teknike

Kontrollat mjekësore




Grafiku 19. Kontrollat mjekësore

Aksidentet




Grafiku 20. Aksidentet

Aksidentet e lehta sipas veprimtarisë




Grafiku 21. Aksidentet e lehta sipas veprimtarisë

Aksidentet e rënda sipas veprimtarisë



Grafiku 22. Aksidentet e rënda sipas veprimtarisë

Aksidentet me fatalitet sipas veprimtarisë



Grafiku 23. Aksidentet me fatalitet sipas veprimtarisë